



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç) pika 1.7. paragrafi (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke u mbështetur në nenin 5 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjar.

Duke pasur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikat e veprimit për zhvillimin e resurseve njerëzore nga fusha e mirëqenies sociale .

Me qellim të rregullimit dhe avancimit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr .01 /2006
PËR
THEMELIMIN DHE PUNËN E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE**

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

(1) Ky Udhëzim Administrativ ka për qellim që në mënyrë unike dhe standarde të rregulloj ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe të kontrolloj kualitetin e këtyre shërbimeve dhe në të njëjtën kohë ta mandatoj Këshillin e Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare

(në vazhdim të tekstit Këshilli) që të jetë si mirëmbajtës i standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe në këtë kuptim të jetë edhe si licencues për profesionistët që punojnë në këtë fushë.

Neni 2

Këshilli i përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare

(1) Këshilli si një mekanizëm i krijuar me Ligjin për shërbime Sociale dhe familjare është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët ushtrojnë punën e tyre në institucionet e shërbimeve sociale dhe familjare .

(2) Pas tri viteve të para të funksionimit, Këshilli do të bëjë licencimin e profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në Kosovë.

(3) Për licencimin e profesionistëve dhe mirësjelljen e tyre , Këshilli do të nxjerr rregulla të veçanta dhe do përcaktoj kodin etik të tyre .

Neni 3

Themelimi i këshilli të përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare

(1) Në mandatin e parë, në kohëzgjatje prej tri vitesh anëtarët e Këshillit i emëron Ministri i MPMS-së. Po ashtu Ministri për këtë mandat do të emëroj edhe Kryetarin i cili do ta drejtoj Këshillin në tri vitet e para .

(2) Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe rregullat e këtij Udhëzimi Administrativ, Ministri i MPMS-se e autorizon Departamentin e Mirëqenies Sociale që në emër të MPMS-së , të merr iniciativën për themelimin e Këshillit .

(3) Të gjitha punët paraprake teknike , administrative dhe profesionale përkitazi me themelimin dhe konstituimin e Këshillit do të kryej Departamenti i Mirëqenies Sociale i MPMS-së.

Neni 4

Kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit janë :

(1.1) Dëshmi që ka përvojë pune në lëmi të ngjashme me shërbimet sociale dhe Familjare ,minimumi tri vite përvojë pune.

(1.2) Publikime të ndryshme në lëmin e shërbimeve sociale dhe familjare

(1.3) Të ketë kredibilitet shoqëror, moral dhe legal.

(1.4) Të jetë i diplomuar nga këto lëmi : Punë Sociale , Psikologji , Sociologji , Drejtësi dhe Pedagogji.

(1.5) I mirëseardhur është titulli shkencor në fushat e lartcekura.

Neni 5

Përbërja institucionale dhe numerike e Këshillit

(1) Këshilli do të ketë njëzetë anëtar të cilët për tri vitet e para i emëron ministri, duke siguruar që përbërja e këshillit të përfshijë spektër sa më të gjerë të profesionistëve dhe do të jetë i përfaqësuar nga këto subjekte :

- (1.1) Universiteti i Prishtinës;
- (1.2) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- (1.3) Komuniteti;
- (1.4) Organizatat jo qeveritare

(2) Pas tri viteve të para të punës së tij Këshilli do të ketë funksion vetë organizues dhe nga radhët e veta do të zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit.

(3) Përbërja numerike e Këshillit sipas institucioneve do të jetë :

- (1.1) Njëmbëdhjetë anëtarë zgjidhen nga radhët e profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare që gjenden në regjistrin e këshillit;
- (1.2) Dy anëtarë emërohen nga Asociacioni i Komunave;
- (1.3) Dy anëtarë i emëron Universiteti i Prishtinës;
- (1.4) Një anëtarë i emëruar nga Këshilli i Përgjithshëm Shëndetësor;
- (1.5) Një anëtarë i emëruar nga komuniteti dhe organizatat joqeveritare dhe
- (1.6) Katër anëtar të emëruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Funksionimi i Këshillit

(1) Anëtarët e Këshillit nuk mund që të kenë asnjë pozitë që nuk është në pajtim me funksionet e tyre në Këshill.

(2) Anëtarët e Këshillit, gjatë aktivitetit të tyre në Këshill duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm duke mos qenë të ndikuar nga asnjë grup i interesit në ushtrimin e funksionit të tyre.

(3) Për funksionimin e drejte dhe efikas , Këshilli mund të formoj Sekretarinë e vet dhe Komitete të ndryshme për realizimin e objektivave të veta.

(4) Këshilli, punën e vet e zhvillon në mbledhje apo në format tjera të cilat mund të përcaktohen në Rregulloren për Punën e Këshillit

Neni 7
Rregullat për punën e Këshillit

(1) Këshilli për punën e vet dhe çështje tjera nga kompetencat dhe përgjegjësitë e tij nxjerr Rregullore pune dhe akte tjera nënligjore, të cilat nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me Dispozitat e përcaktuara me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 8
Kohëzgjatja e shërbimit në Këshill nga anëtarët e Këshillit

(1) Mandati i shërbimit të anëtareve të këshillit është tri vjet me mundësi për rizgjedhje edhe për tri vjet të tjerë. Asnjë anëtar i këshillit nuk mund të kryej këtë funksion më shumë se gjashtë vite (dy mandate) .

(2) MPMS ose vet Këshilli mund ti referojnë Gjykatës Supreme se një anëtarë i Këshillit ka dështuar që ti kryej punët e dala nga rregulloret e këshillit dhe pas shqyrtimit të dëshmime mundet që anëtarin që ka rënë ndesh me detyrat e këshillit ta përjashtoj nga Këshilli .

(3) Në të gjitha rastet kur pushon fushëveprimi i një anëtar i Këshillit, Ministri i MPMS-së emëron anëtar të ri që shërben për kohën e mbetur të mandatit të anëtarit të cilin e zëvendëson.

Neni 9
Institucionet përgjegjëse për krijimin e kushteve të punës te Këshillit

(1) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale , përkatësisht Departamenti i Mirëqenies Sociale i siguron kushtet e punës, për funksionim te drejt dhe efikas te Këshillit.

(2) Për angazhimin e tyre në Këshill, anëtarët do te marrin një honorar të cilin do ta caktoj Ministria e Ekonomisë dhe financave .

(3) Financimi i fushëveprimit të Këshillit do te behet nga pagesat e taksave te regjistrimit për profesionistet e shërbimeve sociale dhe familjare dhe nga buxheti i MPMS-së

Neni 11
Hyrja ne fuqi

(1) Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të aplikohet nga dita e themelimit të Këshillit

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj

Prishtinë, Janar 2006